




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipal off Kacanik
-KUVENDI I KOMUNËS-

01Nr. 16-2196/14
Kaçanik, 31.01.2014

Në bazë të nenit 17 (h), (f) dhe (r) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 17 alinea 2 e Rregullores për caktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve 01 Nr. 16-27192/12, si dhe nenit 40 pika 4 e Ligjit për Arsimin Parauniversitar Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr. 04/L-047, me propozimin e kryetarit të komunës prej datës 21.01.2014, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 31.01.2014, mori këtë,

VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I.

Me këtë Vendim Lejohet ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë, 60.000€ (gjashtëdhjetëmijë euro) për realizimin e këtyre projekteve:

1. Transporti i nxënësve të shkollave të mesme për muajt; Janar deri në Qershor, me 50% të mujores,
2. Transporti i nxënësve nga Gllloboçica dhe Shtraza për muajt; Janar deri Qershor me 40% të mujores,
3. Transporti i nxënësve me nevoja speciale për muajt; Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Shtator, Tetor, Nëntor, dhe Dhjetor,
4. Transporti i nxënësve nga Semaja dhe Sllatina për muajt shkollor; Janar-Qershor,
5. Aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, për gjashtëmujorin e I-r të vitit 2014,
6. Subvencionimi i Shoqërive Kulture Artistike, Klubet Sportive, dhe KVRL, për gjashtëmujorin e I-r të vitit 2014.

II.

Shuma e mjeteve nga pika I e këtij vendimi do të sigurohen nga Programi buxhetor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, përkatësisht nga kategoria buxhetore e Subvencioneve dhe Transfereve, dhe do të shpërndahen sipas Planit të hartuar të kësaj drejtorie.

III.

Pjesë përbërse e këtij Vendimi është: Plani i shpenzimeve buxhetore për aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Financimin e Shoqërive Kulturore-Artistike (SHKA), Klubeve Sportive, dhe KVRL, dhe Kostoja e Transportit për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme si dhe të nxënësve me nevoja speciale.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi komunës.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës,
2. Kryetari i Komunës,
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe
4. Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit.
Xhelal Gashi

